



### Aplikim për vizë me qëllim kurs gjuhe

Lutemi të lexoni me kujdes këtë fletë-informacioni dhe formularin e aplikimit dhënë bashkëngjitur. Duke qenë i/e përgatitur mirë ju mund të ndikoni pozitivisht dhe të shkurtoni procedurën përkatëse.

#### I gjithë dokumentacioni duhet të paraqitet në origjinal!

Në rastin e aplikimit për vizë Ambasada, si rregull, duhet të përfshijë në procedurë zyrën përkatëse për të huajt në Gjermani. Për këtë arsye procedurat zgjasin zakonisht 8-10 javë, në raste të vecanta edhe më gjatë. Ndaj lutemi për mirëkuptimin Tuaj që brenda 8 javëve të para, prej ditës së aplikimit, nuk mund t'u japim përgjigje pyetjeve lidhur me stadin aktual të procedurës.

Të gjitha dokumentat që tërhiqen pranë Ambasadës (fletët e informacionit, formularët e aplikimit) janë gratis. Të gjitha informacionet rreth procedurës së aplikimit i gjeni në faqen e internetit të Ambasadës.

Lutemi të vini re udhëzimet e dhëna për çdo pikë, në mënyrë të veçantë numrin e kopjeve të nevojshme.

1.	<b>Pashaporta e udhëtimit</b> <i>+ 2 kopje (të gjitha faqet e rëndësishme)</i>	Me të paktën dy faqe bosh. Lutemi mbani në konsideratë që afati i vlefshmërisë së pashaportës duhet të jetë tre muaj më i gjatë se kohëzgjatja e vizës. Fotokopjoni ju lutem fletën e plastifikuar me të dhënat personale.	
2.	<b>2x formularë aplikimi për vizë</b>	Në gjermanisht ose anglisht, të plotësuara në mënyrë plotësisht të lexueshme, të nënshkuara personalisht.	
3.	<b>2x fotografi</b>	2 fotografi identike biometrike për pashaportë, jo më të vjetra se 6 muaj.	
4.	<b>Tarifa</b>	Tarifa është 60 €, e pagueshme në Lek, plus një tarifë e përgjithshme për shpenzime telefonike prej 500 Lekësh	
5.	<b>Konfirmim i regjistrimit në kursin e gjuhës</b> <i>+ 2 kopje</i>	Në origjinal duke dhënë numrin e orëve javore të kursit (Kurs intensiv me të paktën 18 orë në javë) dhe konfirmim i pagesës së tarifës së kursit. Kujdes!: Kursi i integritimit nuk konsiderohet kurs në kuptimin e kësaj flete informacioni	
6.	<b>Dëshmi e financimit</b>	Vërtetim për mundësi financimi prej të paktën	

	+ 2 kopje	<p>720 euro në muaj për një vit. Kjo do të thotë se duhet të dëshmohet minimalisht një shumë financiare prej 8640 eurosh. Kjo mund të bëhet në këto mënyra:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Një deklaratë garancie sipas §§66-68 të Ligjit për të Huajt, në të cilën një person i tretë merr përsipër me shkrim kostot përkatëse (pranë Zyrave të të Huajve në Gjermani mund të gjenden formularët e deklaratave të tilla të garancisë). Kjo deklaratë garancie duhet të përmbajë informacionin për qëllimin e synuar të qëndrimit dhe kohëzgjatjen e tij; po kështu kapaciteti financiar duhet të vërtetohet me dokumentin përkatës (shënimi "glaubhaft gemacht" – "i besueshëm" – nuk mjafton për një qëndrim afatgjatë)</li> </ul> <p>Ose</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Përmes derdhjes së shumës përkatëse në një logari bankare të bllokuar në Gjermani. Konfirmimi përkatës i bankës duhet të jetë në original</li> </ul>	
7.	<b>Curriculum Vitae (nëse kërkohet)</b> + 2 kopje	Curriculum Vitae i formuluar nga vetë aplikuesi, duke paraqitur në mënyrë të veçantë arsimimin dhe eventualisht veprimtarinë profesionale të deritanishme.	
8.	<b>Shkresë motivimi</b> + 2 kopje	Shkresë motivimi e formuluar nga vetë aplikuesi për studimet e planifikuara. Ju lutem trajtoni ndër të tjera edhe çështjet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> <li>Si, ku dhe prej sa kohësh mësoni gjermanisht?</li> <li>Pse ju nevojiten njohuritë e gjuhës gjermane?</li> </ul>	
	<b>Dëshmi e gjuhës gjermane</b> + 2 kopje	Dëshmi për nivelin aktual të njohurive të gjuhës gjermane.	
10.	<b>Dëshmi për një siguracion shëndetësor të mjaftueshëm</b> + 2 kopje	Kjo dëshmi duhet të paraqitet për të gjithë periudhën e qëndrimit në momentin e tërheqjes së vizës.	
11.	<b>Minorenët</b>	Në rastin e minorenëve nevojitet edhe certifikata e tyre e lindjes (eventualisht e legalizuar) + 2 kopje dhe një deklaratë dakordësie e noterizuar e prindërve për largimin e fëmijës dhe kursin e gjuhës + 2 kopje	

Në raste të veçanta, gjatë aplikimit apo procedurës së vizës, mund të kërkohen dokumenta të caktuara të papërmendura më sipër.